



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1 Prot.

Tiranë, më 03.01.2019

V E N D I M
Nr.1, datë 03.01.2019

**PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS SË INSTITUCIONIT
PËR VITIN 2019**

Në bazë të Nenit 11, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Nenit 6, pika 3, të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil” dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”,

V E N D O S A :

1. Të miratoj Planin Vjetor të Punës së Institucionit për vitin 2019.
2. Kryerjen e mbikëqyrjeve/inspektimeve jashtë këtij Plani, në varësi të problematikave të evidentuara nga informacionet që do të marrë Komisioneri nga burime të ndryshme.
3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, Drejtoria e Mbikëqyrjes, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha



Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil

PLANI VJETOR I PUNËS 2019

Tiranë, Janar 2019

PLANI VJETOR 2019

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT

Nr.	Subjekti i mbikëqyrjes	Arësyeja e mbikëqyrjes/inspektimit	Drejtoria përgjegjëse	Koha e mbikëqyrjes/inspektimit e ndarë në 3-mujorë			
				I	II	III	IV
A.	Mbikëqyrje/inspektim i orientuar në mbledhjen e informacionit						
	<p>Në këtë proces do të përfshihen të gjitha procedurat e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në institucionet që punësojnë nëpunës civilë, në administratën shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Administratës Publike. • Njësitë përgjegjëse në Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Institucionet e Pavarura. 	<p>Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është institucioni që siguron zbatimin e parimeve të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Gjatë një procedure që zhvillohet për plotësimin e një pozicioni të lirë, pjesë e shërbimit civil, duhet të respektohen parimet e pranimit në shërbimin civil, që janë parimi i shanseve të barabarta, emërimi në bazë të meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit, që sigurohen nëpërmjet një procesi përzgjedhës dhe transparent.</p> <p>Në këto rrethana, duke marrë parasysh rëndësinë e madhe të procesit, Komisioneri e ka përcaktuar si prioritet ndjekjen e tij nëpërmjet inspektorëve të ngarkuar për ta mbikëqyrur zhvillimin e tij përgjatë gjithë vitit kalendarik, sipas një metodologjie të përcaktuar në rregulloren e institucionit, në të gjitha subjektet që punësojnë nëpunës civilë..</p> <p>Problematikat që do të evidentohen gjatë këtij procesi do të shërbejnë për të ndërhyrë më tej për të rregulluar paligjshmëritë e konstatuara.</p>	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit	Po	Po	Po	Po

B.	Mbikëqyrje/inspektim i përgjithshëm						
Njësitë e Qeverisjes Vendore							
1	Bashkia Elbasan dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj	Përfshirja e subjektit në mbikëqyrje të përgjithëshme bazohet në informacionet e ardhura në adresë të Komisionerit, prej nëpunësve civilë, me objekt institute të ndyshme të ligjit për nëpunësin civil, si dhe duke marrë parasysh, procesin e vështirë të implementimit të reformës territoriale në njësitë e qeverisjes vendore. Ky proces shoqërohet me aplikimin e institutit të ristrukturimit, për shkak të pakësimit të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, apo ndryshimit të përshkrimit të punës dhe mbart me vete rrezikun për të gabuar, që në këtë rast vlerësohet i lartë. Për këtë arsye, lind nevoja të mbikëqyret zbatimi i ligjit gjatë këtij procesi dhe në rast parregullsie të rekomandohet njësia përgjegjëse për të rregulluar pasojat, duke e mbështetur edhe me asistencë teknike.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit			Po	
2	Bashkia Shkodër dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj	Përfshirja e subjektit në mbikëqyrje të përgjithëshme bazohet në informacionet e ardhura në adresë të Komisionerit, prej nëpunësve civilë, me objekt institute të ndyshme të ligjit për nëpunësin civil, si dhe duke marrë parasysh, procesin e vështirë të implementimit të reformës territoriale në njësitë e qeverisjes vendore. Ky proces shoqërohet me aplikimin e institutit të ristrukturimit, për shkak të pakësimit të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, apo ndryshimit të përshkrimit të punës dhe mbart me vete rrezikun për të gabuar, që në këtë rast vlerësohet i lartë. Për këtë arsye, lind nevoja të mbikëqyret zbatimi i ligjit gjatë këtij procesi dhe në rast parregullsie të rekomandohet njësia përgjegjëse për të rregulluar pasojat, duke e mbështetur edhe me asistencë teknike.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit			Po	

3	Bashkia Kavajë dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj	Përfshirja e subjektit në mbikëqyrje të përgjithëshme bazohet në informacionet e ardhura në adresë të Komisionerit, prej nëpunësve civilë, me objekt institute të ndyshme të ligjit për nëpunësin civil, si dhe duke marrë parasysh, procesin e vështirë të implementimit të reformës territoriale në njësitë e qeverisjes vendore. Ky proces shoqërohet me aplikimin e institutit të ristrukturimit, për shkak të pakësimit të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, apo ndryshimit të përshkrimit të punës dhe mbart me vete rrezikun për të gabuar, që në këtë rast vlerësohet i lartë. Për këtë arsye, lind nevoja të mbikëqyrjet zbatimi i ligjit gjatë këtij procesi dhe në rast parregullsie të rekomandohet njësi përgjegjëse për të rregulluar pasojat, duke e mbështetur edhe me asistencë teknike.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit			Po	Po
4	Bashkia Berat dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj	Përfshirja e subjektit në mbikëqyrje të përgjithëshme bazohet në informacionet e ardhura në adresë të Komisionerit, prej nëpunësve civilë, me objekt institute të ndyshme të ligjit për nëpunësin civil, si dhe duke marrë parasysh, procesin e vështirë të implementimit të reformës territoriale në njësitë e qeverisjes vendore. Ky proces shoqërohet me aplikimin e institutit të ristrukturimit, për shkak të pakësimit të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, apo ndryshimit të përshkrimit të punës dhe mbart me vete rrezikun për të gabuar, që në këtë rast vlerësohet i lartë. Për këtë arsye, lind nevoja të mbikëqyrjet zbatimi i ligjit gjatë këtij procesi dhe në rast parregullsie të rekomandohet njësi përgjegjëse për të rregulluar pasojat, duke e mbështetur edhe me asistencë teknike.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit			Po	Po
Institucione të Administratës Shtetërore							
1	Institucionet e varësisë Ministria e Financave dhe	Mbikëqyrja në këtë institucion është planifikuar në kuadër të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionet e varësisë në	Drejtoria e Përgjithshme e			Po	Po

	Ekonomisë	administratën shtetërore. Ky proces synon të shtrihet në veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse në lidhje me proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e në vijim.	Mbikëqyrjes dhe Inspektimit				
2	Institucionet e varësisë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe	Mbikëqyrja në këtë institucion është planifikuar në kuadër të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionet e varësisë në administratën shtetërore. Ky proces synon të shtrihet në veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse në lidhje me proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e në vijim.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit			Po	Po
3	Institucionet e varësisë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Mbikëqyrja në këtë institucion është planifikuar në kuadër të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionet e varësisë në administratën shtetërore. Ky proces synon të shtrihet në veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse në lidhje me proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e në vijim.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit			Po	Po
C.	Mbikëqyrje/inspektim tematik						
1	Të gjitha institucionet që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.	Në kuadrin e monitorimit të sjelljes së nëpunësve civil gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet në njësitë e vetqeverisjes vendore, Qershor 2019. Përfshihet nxjerrja e udhezimeve, metodologjisë dhe inspektimit të vazhdueshëm të institucioneve pjesë e shërbimit civil.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit			Po	Po

2	<p>Institucionet e Administratë Shtetërore dhe institucionet e varësisë (Kryeministria, Ministrinë e Linjës dhe institucionet e varësisë)</p>	<p>Komisioneri në vitin 2018, me urdhërin e brendshëm nr. 589, datë 01.08.2018, ka filluar procesin e monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civil në detyrë. Ka filluar puna dhe po vijon, për sigurimin dhe administrimin e dokumentacionit nga institucionet që janë subjekt i ligjit për nëpunësin civil. Me evidentimin e nivelit të zbatimit të ligjit, si dhe administrimin e plotë të të dhënave dhe pas kryerjes së hetimit të plotë administrativ do, të vazhdojë me procedurat e mëtejshme, për të siguruar zbatimin e vendimeve gjyqësore.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit</p>	Po	Po	Po	
3	<p>Institucionet e Pavarura (Institucionet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj të veçantë)</p>	<p>Komisioneri në vitin 2018, me urdhërin e brendshëm nr. 589, datë 01.08.2018, ka filluar procesin e monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civil në detyrë. Ka filluar puna dhe po vijon, për sigurimin dhe administrimin e dokumentacionit nga institucionet që janë subjekt i ligjit për nëpunësin civil. Me evidentimin e nivelit të zbatimit të ligjit, si dhe administrimin e plotë të të dhënave dhe pas kryerjes së hetimit të plotë administrativ do, të vazhdojë me procedurat e mëtejshme, për të siguruar zbatimin e vendimeve gjyqësore.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit</p>	Po	Po	Po	
4	<p>Institucionet e Qeverisjes vendore (Bashkitë dhe Këshillat e Qarqeve)</p>	<p>Komisioneri në vitin 2018, me urdhërin e brendshëm nr. 589, datë 01.08.2018, ka filluar procesin e monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civil në detyrë. Ka filluar puna dhe po vijon, për sigurimin dhe administrimin e dokumentacionit nga institucionet që janë subjekt i ligjit për nëpunësin civil. Me evidentimin e nivelit të zbatimit të ligjit, si dhe administrimin e plotë të të dhënave dhe pas kryerjes së hetimit të plotë administrativ do, të vazhdojë me procedurat e mëtejshme, për të siguruar zbatimin e vendimeve gjyqësore.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit</p>	Po	Po	Po	
D.	<p>Mbikëqyrje në vazhdim në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit</p>						

F.	Verifikimi i informacioneve të ardhura në adresë të Komisionerit dhe zgjidhja e rasteve individuale						
	Institucione të Administratës Shtetërore, Njësi të Qeverisjes Vendore dhe Institucione të pavarura	Në këtë proces do të përfshihet verifikimi i informacioneve që vijnë nga burime të ndryshme dhe zgjidhja e rasteve individuale që kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme të Komisionerit, me qëllim që institucioni t'i përgjigjet në kohë reale dinamikës së lartë të zhvillimeve në administratën publike.	Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit	Po	Po	Po	Po

PLANI VJETOR 2019

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Nr.	Aktiviteti	Afati
I. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit të mbartura nga viti 2018 për të cilat ka përfunduar afati i lënë në vendimin paralajmërues		
1.	Instituti i Transportit	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
2.	Autoriteti i Konkurrencës	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
3.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
4.	Bashkia Librazhd	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
5.	Bashkia Skrapar	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
6.	Bashkia Poliçan	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
7.	Bashkia Has	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
8.	Bashkia Cërrik	Tremujori i parë – Tremujori i tretë
9.	Bashkia Mirditë	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
10.	Bashkia Gramsh	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
11.	Bashkia Peqin	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
12.	Bashkia Këlcyrë	Tremujori i parë – Tremujori i dytë

13.	Inspektorati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse	Tremujori i parë – Tremujori i tretë
14.	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural	Tremujori i parë – Tremujori i tretë
15.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Lushnje, Vlorë	Tremujori i parë – Tremujori i tretë
16.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Shkodër, Fushë-Krujë	Tremujori i parë – Tremujori i tretë
17.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë	Tremujori i parë – Tremujori i tretë
18.	Bashkia Selenicë	Tremujori i parë – Tremujori i tretë
19.	Bashkia Himarë	Tremujori i parë – Tremujori i tretë
20.	Bashkia Malësi e Madhe	Tremujori i parë – Tremujori i tretë

II. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit për proceset e nisura në vitin 2018 e të cilat pritet të përmbyllet me vendim paralajmërues në vitin 2019

1.	Bashkia Vau - Dejës	Tremujori i tretë – Tremujori i katërt
2.	Bashkia Kolonjë	Tremujori i tretë – Tremujori i katërt
3.	Bashkia Fier	Tremujori i tretë – Tremujori i katërt
4.	Bashkia Tropojë	Tremujori i tretë – Tremujori i katërt
5.	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	Tremujori i tretë – Tremujori i katërt
6.	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit	Tremujori i tretë – Tremujori i katërt

III. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit të cilat kanë rezultuar të pazbatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në vazhdim

1.	Bashkia Prrenjas	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
2.	Bashkia Konispol	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
3.	Bashkia Pogradec	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
4.	Bashkia Finiq	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
5.	Bashkia Delvinë	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
6.	Bashkia Sarandë	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
7.	Bashkia Kuçovë	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
8.	Bashkia Dibër	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
9.	Bashkia Lezhë	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
10.	Bashkia Divjakë	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
11.	Bashkia Klos	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
12.	Bashkia Kurbini	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
13.	Bashkia Roskovec	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
14.	Bashkia Lushnje	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
15.	Bashkia Korçë	Tremujori i parë – Tremujori i dytë
16.	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	Tremujori i parë – Tremujori i dytë

IV. Ndjekje e zbatimit të vendimeve të Komisionerit të cilat do të dalin në përfundim të procesit të mbikëqyrjes/inspektimit gjatë vitit 2019		
1.	Ndjekje e zbatimit të vendimeve të Komisionerit nga institucionet e mbikëqyrura / inspektuara brenda afateve të përcaktuara në vendim.	Janar – Dhjetor 2019
V. Përfshirje në mbikëqyrje/inspektim		
1.	Përfshirje në grupet e punës së mbikëqyrjes/inspektimit.	Janar – Dhjetor 2019
VI. Përfaqësim në proceset gjyqësore administrative, në të gjitha shkallët e gjyqësorisë		
1.	Përfaqësim i institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil gjatë të gjitha proceseve gjyqësore administrative, në të gjitha shkallët e gjyqësorisë, duke ndjekur rregullisht çdo seancë gjyqësore.	Janar – Dhjetor 2019
VII. Bashkëpunimi me institucionet apo organizmat e huaj, brenda & jashtë vendit		
1.	Organizimi i pjesëmarrjes së delegacionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Konferencën Ndërkombëtare 2019, që organizohet nga Instituti Ndërkombëtar i Shkencave Administrative (IIAS), në Singapor.	Qershor 2019
2.	Organizimi i pjesëmarrjes së delegacionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Konferencën Vjetore 2019, që organizohet nga Shoqata Ndërkombëtare e Shkollave dhe Instituteve të Administratës (IASIA), në Lisbonë, Portugali.	Korrik 2019



Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

3.	Vendosja e kontakteve me institucione apo organizma të tjerë të huaj, brenda dhe jashtë vendit dhe organizimi i takimeve apo vizitave të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit me këto institucione.	Janar – Dhjetor 2019
----	--	----------------------

PLANI VJETOR 2019

DREJTORIA E FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	REZULTATI
Hartimi i Raportit Vjetor 2018 mbi veprimtarinë e Komisionerit për fushën e financës dhe shërbimeve mbështetëse.	Hartimi i draft - raportit; Koordinim brenda drejtorisë me qëllim mbledhjen e informacioneve/statistikave në lidhje me performancën dhe treguesit tekniko-ekonomikë vjetorë.	Janar-Shkurt 2019	Raporti Vjetor 2018 i hartuar dhe përcjellje tek Drejtori i Përgjithshëm;

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	REZULTATI
Funksionimi normal i strukturës së KMSHC-së.	Publikimi i planit të pranimit në shërbimin civil për vitin 2019; Ndjekja e procesit të rekrutimit në përputhje me ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”; Vlerësimi periodik i punonjësve (me status të punonjësit civil/ ose në kohë prove) si dhe mbledhja dhe përpunimi i rezultateve për hartimin e raportit; Vlerësime individuale, konfirmim i nëpunësve dhe procedura disiplinore sipas rastit; Nisja e procedurës për ndryshimin e strukturës së Komisionerit (KMSHC) në drejtim të forcimit të kapaciteteve të tij.	Janar – Shkurt Çdo 6 muajor Gjatë vitit	Strukturë e konsoliduar (31 punonjës); 4 punonjës të përkohshëm me kohë pune të reduktuar. Punonjës të vlerësuar

<p>Transparencë e vazhdueshme e zyrtarëve që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë</p> <p>Marrëdhëniet me publikun</p>	<p>Përgatitja dhe ndjekja e procesit në të gjitha fazat, deri në miratimin e saj të mundshëm.</p> <p>Hartimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit Përgjegjës dhe problematikave të institucionit.</p> <p>Asistencë në procesin e plotësimit dhe dërgimit të deklaratave të pasurisë të zyrtarëve që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë.</p> <p>Kontakte të vazhdueshme me institucionin e ILDKPKI-së në kuadër të bashkëpunimit reciprok të vendosur.</p> <p>Informim i publikut, ofrimi i shërbimeve publike për qytetarët rreth misionit, funksionit dhe qëllimit për të cilin është krijuar Komisioneri.</p>	<p>Mars-Prill</p> <p>Janar-Mars</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p>	<p>Strukturë e rikonceptuar</p> <p>Raport vjetor i dorëzuar.</p> <p>Deklarata të dorëzuara.</p> <p>Publik i informuar</p>
<p>Përmirësim i Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar.</p>	<p>Koordinimi me çdo strukturë, për monitorimin në vazhdimësi të procesit të Menaxhimit Financiar;</p> <p>Marrja e masave në zbatim të nivelit të rreziqeve gjatë veprimtarisë së strukturave;</p> <p>Miratimi i kalendarit të Dokumentit të PBA-së;</p> <p>Hartimi i PBA-së për vitet 2020-2022;</p>	<p>Janar-Shkurt</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Mars-Prill</p> <p>Prill- Shtator-Nëntor</p>	<p>Sistem efektiv menaxhimi.</p> <p>Pyetësor i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të dorëzuar.</p> <p>Buxhet i siguarur dhe i realizuar sipas prioriteteve.</p>

	<p>Evidentimi dhe reflektimi i kërkesave shtesë në fazën strategjike, gjatë negociimit dhe mbrojtjes së buxhetit, për sigurimin e buxhetit real të vitit buxhetor;</p> <p>Përdorimi i buxhetit mbi baza produkti;</p> <p>Analizë e kosto-përfitimit për çdo aktivitet;</p> <p>Mbikëqyrja e finalizimit të procedurave të prokurimit në mbështetje të realizimit me sukses të planit të buxhetit si dhe në mbështetje të fuqizimit të kapaciteteve logjistike prioritare;</p> <p>Efiçensë dhe transparencë gjatë ekzekutimit të buxhetit, nëpërmjet organizimit të takimeve periodike të GMS (Grupi i Menaxhimit Strategjik) dhe dhënies së informacioneve në kohë për vendimmarrje;</p> <p>Raportim i të ardhurave të krijuara dhe shpenzimeve buxhetore të kryera të vitit ushtrimor;</p> <p>Evidentim i risqeve dhe marrja e masave konkrete për reduktimin e tyre, në funksion të sigurimit, zbatimit dhe monitorimit të</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p>	<p>Raporte monitorimi të dorëzuara.</p> <p>Raporte realizimi të procedurave të prokurimit</p> <p>Proces – Verbale dhe Raportime periodike</p> <p>Raportime periodike</p> <p>Raportime periodike</p>
--	---	--	---

	buxhetit 2019.		
Kualifikim i thelluar i burimeve njerëzore të KMSHC-së.	Hartim i planit të trajnimeve për zhvillimin e njohurive shtesë, me burime të brendshme dhe të jashtme; Pjesëmarrje aktive në trajnimet e ofruara nga ASPA dhe/ose organizata publike jopublike apo të huaja.	Gjatë vitit	Staf i trajnuar në nivel profesional/statistika.
Investime në Pajisje dhe Mobilje zyre	Ndjekja e procedurave të prokurimit të shpenzimeve kapitale (investimet), për krijimin e kushteve optimale të punës; Pajisje me mjete kompjuterike dhe elektronike; Analizë e risqeve të funksionimit të brendshëm të sistemeve të instaluar, në funksion të mirëadministrimit të infrastruktures.	Gjatë vitit	Ambjente me standarde për çdo post pune. Raportime periodike.
Rikonceptim, transparencë, zhvillim dhe monitorim i faqes zyrtare.	Rikonceptim dhe përditësimi i faqes zyrtare të institucionit; Raportime mujore nga çdo drejtori për materialet e përpunuara për publikim;	Gjatë vitit	Faqe zyrtare e përditësuar.
Dixhitalizim i arkivës së institucionit	Përpunim i dokumenteve ekzistuese dhe përgatitja e tyre për t'i dorëzuar në institucionin e Arkivit Qendror Shtetëror.	Gjatë vitit	Dokumentacion i dorëzuar.